ECO TIRANA SHA

Raporti i Audituesit të Pavarur dhe
Pasqyrat Financiare
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

BDO

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2-3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	7
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	8 - 27

Tel: +355 4 2280124
Fax: +355 4 2280126
www.bdo.al

BDO Albania
Blvd. "Deshmoret e Kombit"
Twin Towers , Tower 2, 7th floor
Tirana- Albania

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

Drejtuar Aksionerit dhe Drejtimit të ECO TIRANA SH.A.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë tregtare ECO TIRANA SH.A. ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2020 dhe pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datë 31 dhjetor 2020 si edhe të performancës së saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit ("SKK").

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël (kodi IESBA) të publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët dhe kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe, ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Informacione të tjera

Informacionet e tjera përfshijnë informacione që përfshihen në Raportin Vjetor të Shoqërisë, por nuk përfshihen në pasqyrat financiare dhe raportin tonë të audituesve mbi këto pasqyra. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Raporti Vjetor i Shoqërisë parashikohet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesve. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione. Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera, të identifikuara më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare, apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose, nëse duket se ato përmbajnë anomali materiale. Pasi të lexojmë raportin vjetor, nëse arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë anomali materiale, atëherë ne duhet të komunikojmë për këtë çështje me palët e ngarkuar me qeverisjen.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të, dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuidojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbulimin e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë, se rreziku i mos zbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevantë për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe zbulimeve përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, të zbatuar nga Drejtimi dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin e auditimit tek informacioni i paraqitur në shënimet shpjeguese të lidhura me pasqyrat financiare ose, nëse informacioni i paraqitur në shënimet shpjeguese është i pamjaftueshëm, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund t'i shkaktojnë Shoqërisë ndërprerjen e vazhdimësisë në përputhje me parimin e vijimësisë.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare vjetore, duke përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, si dhe nëse pasqyrat financiare vjetore paraqesin transaksionet dhe ngjarjet kryesore në mënyrë që të arrihet një paraqitje e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Shoqërisë, përveç çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

BDO ALBANIA SHPK

BDO Albania sh.p.k.

26 shkurt 2021
Tiranë, Shqipëri

BDO
BDO ALBANIA sh.p.k.
NIPT L02407004C
TIRANA - ALBANIA

Besjana Doda
Partner Angazhimi

ecoTIRana

❖ PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR (BILANCI)

Nr. Ref.	AKTIVET	VITI USHTRIMOR	
		31 DHJETOR 2020	31 DHJETOR 2019
A-A	**Aktive Afatshkurtra**	**95,619,317**	**66,735,073**
A-A,1	**Mjetet Monetare**	**15,315,308**	**18,997,391**
A-A,2	**Investime:**	-	-
1	Ne tituj pron. te njesive ekonomike brenda grupit	-	-
2	Aksionet e Veta	-	-
3	Te tjera financiare	-	-
	Totali	**15,315,308**	**18,997,391**
A-A,3	**Te drejta te arketueshme**	**69,373,497**	**37,236,336**
1	Nga aktiviteti i shfrytezimit	69,195,832	33,435,631
2	Nga njesite ekonomike brenda Grupit	-	-
3	Nga njesite ekonomike ku ka interesa pjesemarrje	-	-
4	Te tjera	177,666	3,800,705
5	Kapitali aksionar i papaguar		
	Totali	**69,373,497**	**37,236,336**
A-A,4	**Inventari**	**6,152,284**	**6,827,511**
1	Lendet e para & Materiale te konsumueshme	6,152,284	6,827,511
2	Prodhimi ne proces & Gjysem Produkte	-	
3	Produkte te gatshme	-	
4	Mallra per rishitje	-	
5	Aktive Biologjike	-	
6	AAGJ te mbajtura per shitje	-	
7	Parapagime per inventare	-	-
	Totali	**6,152,284**	**6,827,511**
A-A,5	**Shpenzime te Shtyra**	4,248,183	3,252,379
A-A,6	**Te arketueshme nga te ardhurat e Konstatuara**	530,044	421,457
	Total i Aktiveve Afatshkurtra	**95,619,317**	**66,735,073**
A-B	**Aktive Afatgjata**	**234,497,688**	**249,482,426**
A-B,1	**Aktive Financiare**	29,285,714	38,037,821
1	Tituj pronesie ne njesite ekonomike brenda grupit	-	-
2	Tituj te huadhenies ne njesite ekonomike brenda grupit	-	-
3	Tituj pron. ne njesite ekonomike ku ka interesa pjesemarrese	-	-
4	Tituj Huadhe. ne njesite ekonomike ku ka interesa pjesemarrese	-	
5	Tituj te tjere te mbajtur si aktive afatgjata	29,285,714	35,142,857
6	Tituj te tjere te huadhenies	-	2,894,964
	Totali	29,285,714	38,037,821
A-B,2	**Aktive Afatgjata Materiale**	**205,106,386**	**211,303,822**
1	Toka dhe Ndertesa	23,032,353	16,259,625
2	Impiate & Makineri	180,266,599	192,975,476
3	Te tjera Aktive Afatgjata Materiale	1,807,435	2,068,721
4	Parapagime per aktive materiale dhe ne proces	-	-
	Totali	**205,106,386**	**211,303,822**
A-B,3	**Aktive Biologjike**		
A-B,4	**Aktive Afatgjata Jomateriale**	**105,588**	**140,783**
1	Koncesione, Patenta, Licensa, Marka Tregtare	105,588	140,783
2	Emri i mire	-	-
3	Parapagime per AAJM	-	-
	Totali	**105,588**	**140,783**
A-B,5	**Aktive Tatimore te Shtyra**		
A-B,6	**Kapitali i Nenshkruar i papaguar**	-	-
	Totali i Aktiveve Afatgjata	**234,497,688**	**249,482,426**
	TOTALI AKTIVEVE	**330,117,005**	**316,217,500**

ecoTIRANA

❖ PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR (BILANCI)

Nr. Ref.	DETYRIMET DHE KAPITALI	VITI USHTRIMOR	
		31 DHJETOR 2020	31 DHJETOR 2019
D-A-1	**Detyrimet Afatshkurta**	**12,490,908**	**12,695,286**
1	Titujt e huamarrjes	-	-
2	Detyrime ndaj institucioneve te kredise	-	-
3	Arketime ne avance per porosi	-	-
4	Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	845,457	5,516,438
5	Deftesa te pagueshme	-	-
6	Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit	-	-
7	Te pagueshme ndaj njesive ekonomike me pjesmarrje	-	-
8	Te pagueshme Sigurimet dhe Punonjesit	4,612,324	4,283,029
9	Te pagueshme per detyrimet tatimore	6,867,143	2,729,835
10	Te pagueshme te tjera	165,984	165,984
	Totali	**12,490,908**	**12,695,286**
D-A,2	**Te pagueshme per shpenzime te konstatuara**	-	-
D-A,3	**Te ardhura te shtyra**	-	-
D-A,4	**Provizione**	-	-
	Detyrime Totale Afatshkurtra	**12,490,908**	**12,695,286**
D-B,1	**Detyrimet Afatgjata**	**169,200,000**	**212,400,000**
1	Tituj te huamarrjes		-
2	Detyrime ndaj institucioneve te kredise	169,200,000	212,400,000
3	Arketimet ne avance per porosi	-	-
4	Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	-	-
5	Deftesa te pagueshme	-	-
6	Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit	-	-
7	Te pagueshme ndaj njesive ekonomike me pjesemarrje	-	-
8	Te tjera te Pagueshme	-	-
	Totali	**169,200,000**	**212,400,000**
D-B,2	**Te pagueshme per shpenzime te konstatuara**	-	-
D-B,3	**Te Ardhura nga Grantet**	2,557,057	-
D-B,4	**Provizione:**	-	-
i	Provizione per pensionet	-	-
ii	Provizione te tjera	-	-
D-B,5	**Detyrime tatimore te shtyra**	-	-
	Detyrime Totale Afatgjata	**171,757,057**	**212,400,000**
	Detyrime Totale	**184,247,965**	**225,095,286**
K-A	**Kapitali**	**145,869,040**	**91,122,213**
K-A,1	**Kapitali i nenshkruar**	3,900,000	3,900,000
K-A,2	**Primi i lidhur me kapitalin**	-	-
K-A,3	**Rezerva rivleresimi**	-	-
K-A,4	**Rezerva te tjera**	-	-
i	Rezerva statutore	-	-
ii	Rezerva ligjore	-	-
iii	Rezerva te tjera	-	-
K-A,5	**Fitimi i pashperndare**	87,222,213	56,797,740
K-A,6	**Fitimi (humbje) e vitit financiar**	54,746,827	30,424,473
	Totali i Kapitalit	**145,869,040**	**91,122,213**
	TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT	**330,117,005**	**316,217,500**

❖ PASQYRA E PERFORMANCES
(PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE)

Nr. Ref.	TE ARDHURAT DHE SHPENZIMET	VITI USHTRIMOR	
		31 DHJETOR 2020	31 DHJETOR 2019
	TE ARDHURAT	**370,483,101**	**362,215,734**
P-P,1	**Te Ardhurat nga aktiviteti i shfrytezimit**	363,284,599	351,171,347
P-P,2	**Ndryshimet në inventarin e produkteve**	-	-
P-P,3	**Puna e Kryer nga njesia ekonomike dhe**	5,417,554	4,532,642
P-P,4	**Te ardhura te tjera te shfrytezimit**	1,780,948	6,511,746
1	**TOTALI TE ARDHURAVE (Shuma P-P,1-P-P,4)**	**370,483,101**	**362,215,734**
	SHPENZIMET	**(296,600,444)**	**(313,151,006)**
P-P,5	**Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme**	**(84,227,266)**	**(92,534,388)**
1	Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme	(83,614,780)	(92,158,097)
2	Mallra	-	-
3	Te tjera shpenzime	(612,486)	(376,291)
P-P,6	**Shpenzime te personelit**	**(149,705,047)**	**(150,797,583)**
1	Pagat & Shperblimet	(126,694,792)	(127,078,809)
2	-shpenzimet per sigurimet shoqërore dhe shëndetsore	(21,030,367)	(21,100,005)
3	-shpenzime per honorare	(1,979,888)	(2,618,769)
P-P,7	**Zhvleresimi i AAGJ**	-	-
P-P,8	**Shpenzime Konsumi & Amortizimi**	**(41,924,444)**	**(46,350,876)**
P-P,9	**Shpenzime të tjera shfrytezimi**	**(20,743,688)**	**(23,468,159)**
2	**TOTALI SHPENZIMEVE (Shuma P-P,5-P-P,9)**	**(296,600,444)**	**(313,151,006)**
3	**FITIMI OSE HUMBJA NGA VEPRIMTARIA KRYESORE (1 + 2)**	**73,882,657**	**49,064,728**
P-P.10	**Te ardhura te tjera**	**171,867**	**7,493,977**
1	Te ardhura nga njesite ekonomike ku ka	-	-
2	Te ardhura nga njesite ekonomike ku ka	-	-
3	Te ardhura nga investimet dhe huate e tjera pjese e aktiveve	-	-
4	Te ardhura nga investimet dhe huate e tjera pjese e aktiveve	-	-
5	Interesa te arketueshem dhe te ardhura te tjera te ngjashme	11,254	1
6	Interesa te arketueshem dhe te ardhura te tjera te ngjashme,	160,612	7,493,976
P-P.11	**Zhvleresimi i aktiveve financiare dhe**	-	-
P-P.12	**Shpenzime Financiare**	**(9,550,666)**	**(20,647,461)**
1	Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme	(9,360,518)	(12,685,879)
2	Shpenzime interesi dhe shpenzime te	(190,149)	(7,961,582)
P-P.13	**Pjesa e fitimit/Humbjes nga pjesemarrjet**	-	-
13	**TE ARDHURA/SHPENZIME FINANCIARE**	**(9,378,800)**	**(13,153,484)**
	FITIMI/HUMBJA PARA TATIMIT (3+/-4)	**64,503,858**	**35,911,245**
P-P.15	**Shpenzimet e tatimit mbi fitimin**	**(9,757,031)**	**(5,486,772)**
1	Shpenzimi aktual i tatim fitimit	(9,757,031)	(5,486,772)
2	Shpenzimi i tatim fitimit te shtyre	-	-
3	Pjesa e tatim fitimit te pjesemarrjes	-	-
P-P,16	**FITIMI/HUMBJA NETO E VITIT FINANCIAR**	**54,746,827**	**30,424,473**
P-P,17	**FITIM/HUMBJA PER:**	54,746,827	30,424,473
1	Per pronaret e njesise ekonomike meme		-
2	Interesat jo kontrolluese		-

❖ PASQYRA E TE ARDHURAVE GJITHEPERFSHIRESE

Nr. Ref.	PERSHKRIMI	VITI USHTRIMOR	
		31 DHJETOR 2020	31 DHJETOR 2019
	TE ARDHURAT GJITHEPERFSHIRESE		
P.AGJ.1	Fitim Humbja e Vitit	54,746,827	30,424,473
P.AGJ.2	Te Ardhurat Gjitheperfshirese per vitin	-	-
1	Diferencat (+/-) nga perkthimi i monedhes ne veprimtari te huaja		
2	Diferencat (+/-) nga rivleresimi i aktiveve afatgjata materiale		
3	Diferencat (+/-) nga rivleresimi i aktiveve financiare te mbajtura per shitje		
4	Pjesa e te ardhurave gjitheperfshirese nga pjesemarrjet		
5	Totali i te ardhurave te tjera gjitheperfshirese per vitin		
	Totali i te ardhurave gjitheperfshirese per vitin	54,746,827	30,424,473
P-P.17	Totali i te ardhurave gjitheperfshirese per:	54,746,827	30,424,473
1	Pronaret e njesise ekonomike meme		
2	Interesat jo-kontrolluese		

❖ PASQYRA E FLUKSIT MONETAR

Nr. Ref.	FLUKSI MONETAR	VITI USHTRIMOR	
		31 DHJETOR 2020	31 DHJETOR 2019
I			
1	**Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(perdorur ne) aktivitetin e shfrytezimit**	**67,369,321**	**137,157,387**
i	Te arketuara nga te drejtat e arketueshme	375,383,890	401,223,250
ii	Te paguara per detyrimet e pagueshme	(295,609,694)	(237,244,923)
iii	Pagesa te Tjera	-	-
1-A	Mjete Monetare te gjeneruara nga aktiviteti i shfrytezimit	79,774,196	163,978,326
i	Interesi i paguar	(9,360,518)	(12,685,879)
ii	Tatim mbi fitimin i paguar	(3,044,357)	(14,135,060)
	MM neto nga/(perdorur ne) veprimtaritë e shfrytëzimit	**67,369,321**	**137,157,387**
2	**Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(perdorur ne) aktivitetin e investimit**	**(30,408,460)**	**(22,754,881)**
i	Para neto te perdorura per blerjen e filialeve	-	-
ii	Para neto te arketuara nga shitja e filialeve	-	-
iii	Pagesa per blerje AAGj	(30,408,460)	(22,754,881)
iv	Arketime nga shitja e AAGJ	-	-
v	Pagesa per blerjen e investimeve te tjera	-	-
vi	Arketime nga shitja e investimeve te tjera	-	-
vii	Dividente te arketuar	-	-
	MM neto nga/(të përdorura) në aktivitetin investues	**(30,408,460)**	**(22,754,881)**
3	**Fluksi i mjeteve monetare nga/(perdorur ne) ne aktivitetetin e financimit**	**(40,642,943)**	**(96,749,764)**
i	Arketime nga emetimi i kapitalit aksionar	-	-
ii	Arketime nga emetimi i aksioneve te perdorura	-	-
iii	Hua te Arketuara	(40,642,943)	(69,113,306)
iv	Pagesa e kostove te transaksionit qe lidhen me	-	-
v	Riblerja e aksioneve te veta	-	510,000
vi	Pagesa e aksioneve te perdorura si kolateral		-
vii	Detyrime e Huase	-	(28,146,459)
viii	Pagesa e detyrimeve te qirase financiare		-
ix	Interesi I arketuar	-	1
x	Dividente te paguar		-
	Mjete monetare neto nga/ (perdorur ne) aktivitetin financiar	**(40,642,943)**	**(96,749,764)**
4	**Rritja/rënia neto ne mjeteve monetare dhe ekuivalenteve te mjeteve monetare**	**(3,682,082)**	**17,652,742**
5	**Mjetet monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare me 1 Janar**	**18,997,391**	**1,344,649**
6	**Efekti i luhatjeve te kursit te kembimit te mjeteve monetare**	-	-
7	**Mjetet monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare me 31 Dhjetor**	**15,315,308**	**18,997,391**

❖ PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALIN NETO

LEVIZJA E KAPITALEVE	KAPITALI AKSIONAR	PRIMI I LIDHUR ME AKSIONIN	REZERVA	FITIMI I PA SHPERNDARE	FITIMI I VITIT FINANCIAR	TOTALI
Pozicioni financiar me 31 Dhjetor 2018	**3,900,000**			**13,425,360**	**43,372,380**	**60,697,740**
Efekti i ndryshimeve në politikat kontabël						
Pozicioni financiar i rideklaruar me 1 Janar 2019				**43,372,380**	**(12,847,907)**	**30,424,473**
Te ardhurat totale gjitheperfshirese per vitin:					-	-
Fitim/Humbja e vitit					30,424,473	30,424,473
Te ardhura te tjera gjitheperfshirese						
Te ardhura te tjera gjitheperfshirese per vitin						
Transaksionet me pronaret te njohura ne kap.	-	-	-	43,272,380	(43,272,380)	
Emetimi i kapitalit te nenshkruar						
Dividendët e paguar					-	
Totali i transaksioneve me pronaret e njesise ekonomike						
Pozicioni financiar i rideklaruar me 31 Dhjetor 2019	**3,900,000**			**56,797,740**	**30,424,473**	**91,122,213**
Pozicioni financiar i rideklaruar me 1 Janar 2020	**3,900,000**	-	-	**56,797,740**	**30,424,473**	**91,122,213**
Te ardhurat totale gjitheperfshirese per vitin:				**30,424,473**	**24,322,354**	**54,746,827**
Fitim/Humbja e vitit					54,746,827	54,746,827
Te ardhura te tjera gjitheperfshirese						
Te ardhura te tjera gjitheperfshirese per vitin					-	-
Transaksionet me pronaret te njohura ne kap.				30,424,473	(30,424,473)	
Emetimi i kapitalit te nenshkruar						
Dividendët e paguar						
Totali i transaksioneve me pronaret e njesise ekonomike	-	-	-	-	-	-
Pozicioni financiar i rideklaruar me 31 Dhjetor 2020	**3,900,000**	-	-	**87,222,213**	**54,746,827**	**145,869,040**

❖ SHENIME SHPJEGUESE

Shoqëria ECO TIRANA SH.A. i ka ndertuar Pasqyrat Financiare për vitin 2020 në bazë të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Permiresuara dhe përkatësisht në mbështetje të plotë të SKK 2. Shoqëria i ndërton dhe i paraqet Pasqyrat Financiare sipas **SKK TE PERMIRESUARA** në bazë të Ligjit nr. 25/2018, datë 10.05.2018 "Për Kontabilitetitn dhe Pasqyrat Financiare",i cili ka hyre ne fuqi ne 1 Janar2019, si dhe shenimeve shpjeguese te aplikueshme ne perputhje me nenin 16 te ligjit te siperpermendur. Pasqyrat Financiare janë përgatitur duke ndjekur e zbatuar

Politikat Kryesore Kontabel si: politika për njohjen e aktiveve, për njohjen e detyrimeve, njohjen e të drejtave, njohjen e të ardhurave e shpenzimeve si dhe njohjen dhe vlerësimin e tyre. Gjithashtu gjatë përgatitjes së Pasqyrave Financiare janë pasur parasysh ***Parimet*** si: Parimi i te drejtave dhe detyrimeve te konstatuara, Parimi i Njesise Ekonomike Raportuese, Parimi i vijimesise se veprimtarise ekonomike si dhe Parimi i Kompesimit. ***Karakteristikat*** cilesore të përgatitjes së Pasqyrave Financiare janë ato që e bëjnë informacionin e pasqyrave financiare të dobishem për përdoruesin. Karakteristikat kryesore që janë mbajtur parasysh gjatë hartimit te Pasqyrave Financiare janë: Kuptueshmeria, Rëndësia dhe Materialiteti, Besueshmëria, Parimi i Paraqitjes me Besnikeri, Parimi i Përparësisë së përmbajtjes ekonomike mbi formën ligjore, Paanshmeria, Parimi i maturise, Parimi i plotësisë, Qëndrueshmeria dhe Krahasueshmeria.

Përmbledhje e politikave kontabël

Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me ligjin shqiptar "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit të të drejtave të konstatuara. Ato paraqiten në monedhën vendase, Lekë Shqiptar (lekë).

Standartet Kombëtare të Kontabilitetit zbatohen cdo vit dhe aplikimi i tyre, sipas kërkesave të SNK-ve, është bërë në mënyrë perspektive. Si pasojë shifrat e vitit ushtrimor janë të krahasueshme me ato të vitit paraardhes, pasi janë zbatuar politika kontabël të njejta.

Në paraqitjen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor është zbatuar formati i SKK-2 si edhe ne paraqitjen e pasqyrave financiare te vitit paraardhes.

Parimet kontabile më domethënëse që janë përdorur nga shoqëria, janë si më poshtë:

Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri të mjaftueshme në marrjen e përfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përllogariten me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara. Shpenzimet njihen atëherë kur ato sigurohen prej të tretëve dhe në të njëjtin ushtrim kontabël me të ardhurat e lidhura.

Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lek, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në cdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj maten në termat e kostos historike dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja më kryesore më 31.12.2020:

Monedha	Viti 2020	Viti 2019	Ndryshimi
Euro	123.70	121.77	+1.93
USD	100.84	108.64	-7.80
GBP	137.93	143.00	-5.07
CAD	79.14	83.38	-4.24

Tatimin mbi fitimin
Shpenzimi për tatimin mbi fitimin përfaqëson shumën e tatimit per tu paguar për vitin ushtrimor. Tatim fitimi I pagueshëm për vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshëm I cili ndryshon nga fitimi tregëtar që raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për ushtrimin 2020 është 15 %.

Kerkesat per t'u arketuar
Kerkesat per t'u arketuar, te ardhurat e konstatuara dhe llogari te tjera afatshkurtra dhe afatgjata, per t'u arketuar ne para regjistrohen ne bilanc me kosto te amortizuar. Kostoja e amortizuar e kerkesave per t'u arketuar afatshkurtra, ne pergjithesi është e barabarte me vleren e tyre nominale (minus provizionet e krijuara per renie ne vlere), keshtu qe kerkesat afatshkurtra regjistrohen ne bilanc me vleren e tyre neto te realizueshme.

Pasivet financiare
Huate e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje te tjera afatshkurtra dhe afatgjata, per t'u shlyer ne para, ne pergjithesi, mbahen me koston e amortizuar ne bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, ne pergjithesi, është e barabarte me vleren e tyre nominale; keshtu qe pasivet financiare afatshkurtra mbahen ne bilanc ne vleren e tyre neto te realizueshme.

Aktivet Afatgjata Materiale
Aktivet afatgjata materiale (AAM-të) bazohen në modelin e kostos. Në bilanc, një element I AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta nën zërin "tepricë nga rivlerësimi". Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi është llogaritur mbi bazën vleres se mbetur për ndërtesat dhe mbi bazën e vlerës së mbetur për pjesën tjetër të aktiveve të qëndrueshme. Normat e përdorura janë në ndërtesa 5% të vlerës mbetur dhe për aktivet e tjera 20% dhe 25% të vlerës së mbetur.

Gjendjet e inventarët
Vlerësimi në hyrje i inventarëve bëhet me cmimet e blerjes dhe në rastet kur është e aplikueshme u shtohen kostot e shkaktuara për të sjellë inventarët në kushte magazinimi. Gjendjet e inventarit në pasqyrat financiare paraqiten me kostot e blerjeve të fundit të ushtrimit që nga drejtimi është cmuar si vlera neto e realizueshme.

Ne vijim do të interpretojmë vlerat e paraqitura në pasqyrat përkatëse

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR AKTIVET

Zeri A-A,1 Mjete Monetare në fund të vitit kane vlerën **15 315 308** lekë, te ndara ne Mjete Monetare ne Banke dhe Mjete Monetare ne Arke, te ndara sipas monedhave dhe te konvertuara me kursin zyrtar të Bankës së Shqiperise 31/12/2020. Me këtë situatë monetare në fund të vitit, kompania është në gjendje të mirë financiare dhe mund të paguajë të gjitha detyrimet te pasqyruara ne bilanc. Në mënyrën më analitike sipas tabelës me poshte:

Reff.	PERSHKRIMI	VITI USHTRIMOR	
		31 DHJETOR 2020	31 DHJETOR 2019
A-A,1	**MJETET MONETARE**	**15,315,308**	**18,997,391**
A.A.1.1	**Banka**	**15,222,220**	**18,936,087**
i	Vlera monatare ne leke	15,143,565	18,796,839
ii	Vlera monatare ne Euro	78,655	139,248
iii	Vlera monatare ne USD	-	-
A.A.1.2	**Arka**	**93,089**	**61,304**
i	Vlera monatare ne leke	74,112	35,841
ii	Vlera monatare ne Euro	18,977	25,463
iii	Vlera monatare ne USD	-	-

Zëri A-A,3 Te drejta te Arketueshme në fund të vitit kane vlerën **69 373 497** lekë, qe perfaqesojne kerkesa te arketueshme nga klientet nga pale te lidhura,garanci qeraja dhe gjendje kreditore ne dogane te ndara sipas tabeles së mëposhtme në zërat përkatës:

Reff.	PERSHKRIMI	VITI USHTRIMOR	
		31 DHJETOR 2020	31 DHJETOR 2019
A-A,3	**TE DREJTA TE ARKETUESHME**	**69,373,497**	**37,236,336**
A-A,3 1	**Nga Aktiviteti i shfrytezimit**	**69,195,832**	**33,435,631**
A-A,3 2	**Nga njesite ekonomike brenda Grupit**	**-**	**-**
A-A,3 3	**Nga njesite ekonomike me pjesemarrje**	**-**	**-**
A-A,3 4	**Kerkesa te tjera te arketueshme**	**177,666**	**3,800,705**
A-A,3 5	**Kapitali i Nenshkruar i Papaguar**	**-**	**-**

Zëri A-A,3,1 Kerkesa te Arketueshme (Kliente) në fund të vitit kane vlerën **69 195 832** leke, te ndara ne menyre analitike. Klientet ne valute jane konvertuar ne leke me kursin zyrtar te Bankes se Shqiperise dhe paraqiten sipas tabeles së meposhtme:

Reff.	PERSHKRIMI	VITI USHTRIMOR	
		31 DHJETOR 2020	31 DHJETOR 2019
A-A,3	**TE DREJTA TE ARKETUESHME**	**69,195,832**	**33,435,631**
A-A,3 1	**Nga aktiviteti i Shfrytezimit (Kliente)**	**69,195,832**	**33,435,631**
*	BASHKIA TIRANE	68,681,602	32,979,560
*	ALB SIGURACION SHPK		20
*	ERDA SHPK		60,480
*	GALUTEX SHPK		100,826
*	MENDOIL SHPK	46,220	46,220
*	TAIWAN	278,400	181,200
*	XHEKO SHPK	12,000	12,000
*	QENDRA SPORTIVE KUQ E ZI	48,480	79,680
*	GREEN RECYCLING SHPK	79,650	
*	ERMAL SULAJ P.F.	49,480	(24,354)

Zëri A-A,3,4 Te tjera Kerkesa te Arketueshme në fund të vitit kane vlerën **177 666** lekë, te ndara ne menyre analitike sipas tabeles se meposhtme:

Reff.	PERSHKRIMI	VITI USHTRIMOR	
		31 DHJETOR 2020	31 DHJETOR 2019
A-A,3	**TE DREJTA TE ARKETUESHME**	**177,666**	**3,800,705.00**
A-A.3.4	**Te tjera Kerkesa te Arketueshme**	**177,666**	**3,800,705**
i	Parapagime te dhene		-
ii	Garanci te Paguara	170,000	170,000
iii	Debitore		-
iv	Tatim Fitimi	-	3,623,649
v	TVSH Dogane	7,666	7,056
vi	Tatime te tjera		-

Zeri A-A,4, Inventare ne fund te periudhes ka nje vlere per **6 152 284** leke paraqet gjendja e lëndëve të para, materialeve ndihmëse, lëndëve djegëse dhe materialeve të punës përkatësisht sipas vlerave të mëposhtme:

Reff.	PERSHKRIMI	VITI USHTRIMOR	
		31 DHJETOR 2020	31 DHJETOR 2019
A-A,4	**INVENTARE**	**6,152,284**	**6,827,510**
A.A,4.1	**Lende te para**	**6,132,284**	**6,827,510**
*	Materiale Pastrimi	1,131,254	1,091,731
*	Materiale Sherbimi	4,211,067	3,622,892
*	Materiale Karburant, Vajra, Lubrifikant	573,990	581,732
*	Materiale te Konsumueshme Zyre	28,950	28,950
*	Materiale Inventar i Imet	187,023	1,502,206
A.A,4.2	**Prodhim ne proces**	**20,000**	**-**
*	Prodhim ne proces	**20,000**	

Zeri A-A,5,6 Shpenzime të Shtyra e të Ardhura të Konstatuara për **4 778 227** lekë paraqet Shumat e paguara në avancë për shpenzime të periudhave të ardhshme si dhe paraqitura në mënyrë analitike në tabelën e mëposhtme:

Reff.	PERSHKRIMI	VITI USHTRIMOR	
		31 DHJETOR 2020	31 DHJETOR 2019
A-A,5	**Shpenzime te Shtyra e te Ardhura te Konstatuara**	**4,778,227**	**3,673,836**
A.A,6	**Shpenzime te shtyra**	**4,778,227**	**3,673,836**
*	Shpenzime te shtyra per sigurime	3,914,545	2,949,879
*	Shpenzime te shtyra te Tjera	863,682	723,957
*	Te ardhura te llogaritura		-

TOTALI AKTIVEVE AFATSHKURTERA 95 619 317 LEKE

Zeri A-A,5 Aktivet Financiare per vleren **29 285 714** lekë perfaqeson vleren e hua-se te dhene nga shoqeria partnereve te saj. Me 24 Gusht 2017, Eco Tirana Sh.a nenshkroi nje kontrate financimi me Eco Recycling per nje total te mbetur prej 29,285,714 leke. Kjo hua ne baze te akteve premtim pagese te firmosur me date 27.09.2019 para noteres duhet te pagueshin me sipas afateve te percaktuara. Mos pagesa brenda afateve ka detyruar shoqrine Eco Tirana Sh.a te ngre padi dhe te kerkoje urdher ekzekutimin per detyrimin e mbetur. Me vendimin Nr.5482 Akti Dt.02.10.2020 Regj date 14.12.2020 gjykata e shkalles se pare ka rrezuar kerkesen e shoqerise Eco Tirana Sh.a. Ky vendim ka bere qe shoqeria Eco Tirana Sh.a te provigjonoje interesat e krijuara. Ekziston rreziku i moslikuidimit te kesaj hua-je.

Reff.	PERSHKRIMI	VITI USHTRIMOR	
		31 DHJETOR 2020	31 DHJETOR 2019
A-A,5	**Aktive Afatgjata Financiare**	**29,285,714**	**38,037,821**
A.A,6	**Aktive financiare**	**29,285,714**	**38,037,821**
*	Tituj huadhenie te njesite ekonomike ku ka interesa pjesemarrese	-	
*	Hua Afatgjate per Eco Recycling Sh.p.k	29,285,714	35,142,857
*	Interesa te llogaritura	-	2,894,964

Zeri A-B,2 Aktivet Afatgjata Materiale per **205 106 386** lekë perfaqeson vleren neto te A.A.M-ve, nga vlera e blerjes është zbritur amortizimi deri në fund të vitit. AAM-te paraqiten të grupuara sipas tabeles se meposhtme:

Reff.	PERSHKRIMI	VITI USHTRIMOR	
		31 DHJETOR 2020	31 DHJETOR 2019
A.B	**AKTIVE AFATGJATA MATERIALE NETO**	**205,106,386**	**211,303,822**
A.B.2.1	**Toka Troje Terene**	-	-
A.B.2.2	**Ndertesa Ndertime ne Proces**	**23,032,353**	**16,259,625**
A.B.2.3	**Makineri e Paisje**	**180,266,599**	**192,975,476**
